



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale që i përket procedimit penal nr.17/2024, në ngarkim të të pandehurve **Endri Ngresi, Ardjan Kumanaku** dhe **Afërdita Vidhi.**”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjyimit të zakonshëm. Në përfundim të gjyimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Flojera Davidhi, Erjon Bani dhe Erjon Çela, me vendimin Nr. **54**, datë **30.07.2025** vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Endri Ngresi** për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 259, paragrafi i dytë i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.
2. Vuajtja e dënimit për të pandehurin Endri Ngresi do të fillojë nga dita e zbatimit të masës së sigurimit “*arrest në shtëpi*” dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
3. Në zbatim të nenit 35, paragrafi i parë të K.Penal, heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh.
4. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ardjan Kumanaku**, për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244, paragrafi i dytë dhe 25 të K.Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
5. Vuajtja e dënimit për të pandehurin Ardjan Kumanaku do të fillojë nga dita e ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
6. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Afërdita Vidhi**, për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244, paragrafi i dytë dhe 25 të K.Penal.
7. Përjashtimin e të pandehurës Afërdita Vidhi nga dënimi, sipas parashikimit të nenit 52/a të K.Penal.
8. Në zbatim të nenit 190, pika 1 të K.Pr.Penale, telefoni celular i markës “*Samsung Galaxy A10*”, bashkuar me procedimin në bazë të urdhrit “*Për bashkimin e provës materiale*”, datë 27.01.2025, t’i kthehet përdoruesve të tij, shtetasve Afërdita Vidhi dhe K.V.

9. Shpenzimet e fazës hetimore sipas formularit përkatës dhe ato gjyqësore sipas formularit bashkëlidhur, t'i ngarkohen të pandehurve në mënyrë solidare.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë, brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit gjyqësor të arsyetuar.

Tiranë, më datë 30.07.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar